

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë “Sharri”

Themelimi

Parku Kombëtarë „Sharri” është Parku i parë kombëtar i shpallur në vitin 1986 nga Kuvendi i Kosovës. Funksionimi i Parkut Kombëtarë ka filluar në vitin 1995., ndërsa është ndërprerë gjatë periudhës 1999 - 2002 dhe përsëri është riaktivizuar në maj të vitit 2002.

Me Ligjin e ri nr. 03/ L-087 (2013) sipërfaqja e Parkut është rritur në 53.469 ha, e cila shtrihet në territorin e pesë komunave: Kaçanik (4.1%), Suharekë (4.7%), Prizren (22.2%), Shtërpçë (23.9 %) dhe Dragash (45.1%).

Ky Park menaxhohet nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë Sharri me zyre në Prizren, e cila vepron në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë “Sharri” ka 18 punëtor të përhershëm (10 janë staf profesional, teknik dhe 8 janë rojtar të natyrës që mbulohet territori i komunës së Prizrenit dhe Suharekës), ndërsa në bazë të Planit menaxhues të PK “Sharri” (2015) për menaxhimin e qëndrueshëm të PK “Sharri” nevojiten 52 punonjës (24 staf profesional, teknik dhe 28 rojtar të natyrës). Akoma pas 8 viteve të zgjerimit të PK “Sharri” (Ligji PK “Sharri” nr. 04/L-087), nuk janë punësuar punëtorët me kontrata të përhershme dhe nuk është vendosur menaxhimi i plotë institucional i Parkut Kombëtar nga AMMK/MMPHI në komunat Kaçanik, Shtërpçë dhe Dragash, ku shtrihen mbi 70% e territorit të PK “Sharri”.

Drejtori në përbërjen e vet, për momentin, i posedon dy Sektorë, Sektorin e Pylltarisë dhe Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit, të cilët i kryejnë punët nga fusha e tyre profesionale.

Në kuadër të punëtorëve të Parkut Kombëtarë veçohen:

- stafi udhëheqës, profesional dhe administrativ - të cilit punët i kryejnë në zyre dhe në terren, dhe
- kujdestarët - të cilit vazhdimisht janë në terren duke i kryer aktivitetet në mbrojtjen dhe vëzhgimin e resurseve natyrore (pyjeve, florës dhe faunës).

Struktura e territorit të PK “Sharri” sipas përdorimit ka këtë përmbajtje: vegjetacioni barishtor 30,904.85 ha (57.81%), pyjet 18,298.82 ha (34.22%), shkurret 1,419.15 ha (2.65%), ujërat 1,467.64 ha (2.74%); sipërfaqet e zhveshura 1,355.33 ha (2.54%), sipërfaqet urbane 23.21 ha (0.04%). Shumica e territorit (mbi 80 %) i takon pronës publike.

Parku Kombëtarë “Sharri” karakterizohet me bukuri dhe vlera të veçanta natyrore që kanë rëndësi të posaçme shkencore, edukativo-arsimore, rekreative, sportive-turistike dhe estetike. Parku Kombëtarë gjendet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës dhe shtrihet në malet Sharr, Oshlak, Koxha Ballkan dhe Pashallare.

Kufiri jugor i Parkut përputhet me kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës me Maqedoninë dhe Shqipërinë, i cili kalon nëpër majtë më të larta të Sharrit, shume prej të cilëve janë mbi 2500 m të lartësisë mbidetare: Çuka e Liqenit (2604 m), Bistra (2651 m), Maja e Zezë (2584 m), Kobilica (2526 m), etj.

Veprimtaria

Drejtoria e Parkut Kombëtarë „Sharri” i kryen të gjitha funksionet që i takojnë menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore që kanë të bëjnë me planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin. Veprimtarit kryesore në kuadër të menaxhimit të resurseve natyrore janë: mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve natyrore, hulumtimi dhe studimi i vlerave natyrore, shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i pasurive natyrore, kompletimi i infrastrukturës ligjore, organizative dhe financiare për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtarë.

Baza ligjore dhe planifikuese për menaxhimin e PK “Sharri”:

- Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” nr. 04/L-087; Dt. 13.12.2012. (GZRK Nr. 2/2013);
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës 03/L-233 të datës 30.09.2010. (GZRK Nr. 85/2010.);
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L025; Dt. 26.02.2009.
- Vendimi për themelimin e Drejtorisë së PK “Sharri” nr. 344/13 të datës 11.02.2013.
- Rregullore për rendin e brendshëm të parqeve kombëtare nr. 21/2013.
- Plani Hapësinor i Parkut Kombëtar „Sharri” (Vendimi i Kuvendit të Republikë së Kosovës nr. 04-V-772, shkurt 2014)
- Plani i Menaxhimit të PK “Sharri (Vendimi i Ministrit të MMPH-së nr. 18, mars 2015)
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Bashkëpunimi

Menaxhimi i Parkut Kombëtarë Sharri, pasi që bëhet fjalë për resurset më të vlefshme natyrore të vendit, është specifik dhe varët nga koordinimi dhe veprimi i shumë subjekteve institucionale në nivelin lokal dhe qendror.

Me Parkun Kombëtarë menaxhon Drejtoria, mirëpo në funksionimin e Parkut Kombëtarë, në veçanti në mbrojtjen e resurseve natyrore, në mënyrë direkte apo indirekte janë të kyçur edhe institucionet e tjera shtetërore siç janë: qeveritë Komunale, Policia, Prokuroria, Gjykata, Inspektionet, Emergjencia, Brigada e zjarrfikësve, etj., si dhe institucionet joqeveritare siç janë shoqatat ekologjike, gjahtarëve, bjeshkatarëve, peshkatarëve etj.

Drejtoria e PK Sharri e ka strategjinë e bashkëpunimit me të gjitha këto institucione e cila nënkupton kontaktet e përditshme, koordinimin e aktiviteteve dhe veprimet konkrete në mbrojtjen e resurseve natyrore.

Përveç këtyre institucioneve Drejtoria e PK bashkëpunon edhe me institucionet e tjera në nivelin qendror kryesisht në aspektet zhvillimore të Parkut Kombëtarë, siç janë: institucionet e MMPHI (AMMK, IPH, DM, DU etj.), institucionet e Ministrive tjera (MBPZHR, APK, etj.), KFOR-I, OJQ ndërkombëtare (Rrjeti i Parqeve Dinaride, GIZ, USAID, WWF etj.). Bashkëpunimi i mirëfilltë me këto institucione është i rëndësishëm për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtarë.